



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

BURSA UNIVERSITARE DHE PASUNIVERSITARE NË EGJIPT

VITI AKADEMIK 2015-2016

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit me Republikën Arabe të Egjiptit, Ministria e Arsimit të Lartë të Egjiptit ofron 9 (nëntë) bursa studimi (5 bursa për studime universitare dhe 4 bursa për studime pasuniversitare) për studentë shqiptarë të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet në universitetet egjiptiane, për vitin akademik 2015-2016.

Kandidatët e interesuar për këto bursa studimi duhet të paraqesin pranë Drejtorisë së Integritimit dhe Projekteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dokumentet sipas listës në vijim:

Për studime universitare:

1. Kërkesën me shkrim drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku të specifikohet dega e studimit;
2. Vërtetimin e notave për tri vitet e shkollës së mesme. Ky vërtetim duhet të jetë i firmosur nga Drejtoria ose Zyra Arsimore e rrethit përkatës dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
3. Certifikata të ndryshme (të skanuara) për pjesëmarrje në konkurse ose olimpiada në nivel kombëtar ose ndërkombëtar;
4. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
5. Fotokopjen e faqes së të dhënave të pasaportës;
6. Dëshminë e Penalitetit;
7. 4 fotografi

Për programet e studimit master/ studime të avancuara:

1. Kërkesën me shkrim drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku të specifikohet fusha e studimit;
2. Një CV që përmban informacion për ciklet e shkollimit dhe adresat e shkollave ku aplikanti ka studiuar;
3. Kopjen e noterizuar të diplomës që vërteton mbarimin e programit të nivelit të parë të studimeve universitare (Bachelor) ose të nivelit dytë të studimeve (Master Profesional/Master i Shkencave);
4. Letër rekomandimi nga shkolla ose vendi i punës, në rast se aplikanti është i punësuar;
5. Letrën e interesit ose një plan studimi për programin e studimit;
6. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
7. Fotokopjen e faqes së pasaportës;

8. Dëshminë e Penalitetit;
9. 4 fotografi

Aplikantët për studime universitare dhe pasuniversitare do t'i nënshtrohen vitit përgatitor të gjuhës arabe.

Bursa mbulon shpenzimet e ushqimit, të akomodimit dhe tarifën e shkollimit. Ndërsa shpenzimet udhëtimit duhet të mbulohen nga vetë aplikantët.

Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën angleze ose arabe, si dhe të legalizuara nga Ministria e Punëve të Jashtme. Këto dokumente duhet të dorëzohen pranë Drejtorisë së Integrimit dhe Projekteve brenda datës **8 maj 2015**.

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE